



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 128/4 Prot

Tiranë, më 17/03.2015

URDHËR

Nr. 02, datë 17/03/2015

Mbështetur në Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetimit Administrativ, në ngarkim të kontrolluesit, Operator i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Tiranë.

KONSTATOVA:

Pranë kontrolluesit, Operator i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, (OSHEE) Tiranë, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbështetur në Urdhrin Nr.218, datë 01.12.2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka zhvilluar hetimin administrativ me objekt:

- *Verifikimin e Rekomandimit Nr.28, datë 11.04.2014, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.*

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit, provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit vëren se, nga verifikimi i kryer më datë 05/12/2014, nuk janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në rekomandimin e sipërcituar.

Në kundërshtim me detyrën e lënë në Rekomandim, e cila lidhet me nenin 5 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi Operator i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, (OSHEE) Tiranë ka vazhduar me mbledhjen dhe arkivimin e dokumenteve të noterizuara apo origjinale, që vërtetojnë pronësinë e konsumatorit mbi objektin.

Lidhur me moszbatimin e këtij detyrimi të Rekomandimit, kontrolluesi ka paraqitur observacionin e tij në shkresën nr.4542/1 prot., datë 04/06/2014, të përcjellë pranë Zyrës së Komisionerit, ku shprehet se, nuk është në kompetencë të OSHEE-së, hartimi apo ndryshimi i rregulloreve, por është tagri i Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

Nga Zyra e Komisionerit është realizuar një seancë e përbashkët konsultimi me përfaqësuesit e ERE-s (me kërkesë të kësaj të fundit), ku të pranishëm ishin edhe përfaqësues të OSHEE-së. Pas realizimit të takimit, nga ERE është dërguar shkresa nr. 124/1 prot, datë 09.03.2015 me lëndë: *Mbi rishikimin e Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes.*

Në shkresën e sipërcituar, ERE është shprehur se, në Rregullore nuk ka përcaktuar procedurat lidhur me mbajtjen dhe arkivimin e dokumenteve, që vërtetojnë pronësinë e objektit dhe është detyrë e OSHEE sh.a., të respektojë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 5, 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar si dhe konform neneve 107-109 të K.Pr. Administrative ;

URDHËROJ :

1. Kontrolluesi, Operator i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Tiranë, të realizojë në mënyrë të menjëhershme, pezullimin e përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave – konsumator, për sa i përket *mbledhjes dhe arkivimit të dokumenteve origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë pronësinë e objektit;*

2. Kontrolluesi, Operator i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Tiranë, në funksion të kryerjes së ushtrimit të aktivitetit të tij, të realizojë marrjen e dokumentave të pronësisë sipas Rregullores Nr.22, datë 25.02.2012, "*Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes*", kreu, "*Dokumentacioni që kërkohet për lidhje të re, ose modifikim lidhjeje ekzistuese në Tension të Ulët për fuqi të instaluar deri në 20 kw*", dhe konkretisht sipas pikës 6, por dokumenti që arkivohet, të jetë **fotokopje** dhe jo dokumente origjinale ose të noterizuara, që paraqet konsumatori/klienti.

3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, me plotësimin e detyrimit sipas pikës 1, të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

4. Në rast mos përmbushjeje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Komisioneri, në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksione për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

